



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 25366 Prot.

Tiranë, më 30.12.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 8480 Prot.

Tiranë, më 30.12.2020

NJOFTIM I PËRBASHKËT

Drejtuar: Autoriteteve Kontraktore
Operatorëve Ekonomikë

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia e Prokurimit Publik sjellin në vëmendje të autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, si më poshtë vijon:

Sikurse jeni në dijeni, ligji Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet, rregullat, kriteret, detyrimet, afatet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit lidhur me lëshimin e faturës, faturës shoqëruese dhe faturës elektronike, i fillon efektet prej datës 1 Janar 2021, sipas fashave të mëposhtme:

- a) për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, prej datës 1 janar 2021.
- b) për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve, prej datës 1 korrik 2021.
- c) për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit, pavarësisht përgjegjësisë tatimore apo qarkullimit vjetor të realizuar, prej datës 1 shtator 2021.

Referuar sa më sipër, prej datës 1 Janar 2021 tatimpaguesit, të cilët kryejnë transaksione shitje me entet publike, kanë detyrimin ligjor që të lëshojnë vetëm fatura elektronike për mallrat apo shërbimet e shitura.

Në këto kushte, kërkojmë që të merrni masat e duhura për të plotësuar kërkesat e ligjit të sipërcituar, pasi prej datës 01.01.2021, nga Degët e Thesarit nuk do të bëhet asnjë regjistrim apo konfirmim i pagesave për shpenzime të entiteteve publike, nëse ky shpenzim nuk është i deklaruar me një faturë të fiskalizuar.

Ndërkohë, Agjencia e Prokurimit Publik sjell në vëmendje të autoriteteve kontraktore, të cilat do të ndërmarrin procedura prokurimi nga data 1 Janar 2021, që në dokumentat e tenderit që do të shpallin për këto procedura, të informojnë Operatorët Ekonomikë lidhur me kërkesat ligjore të sipërcituara.

Konkretisht, në Njoftimin e Kontratës në Seksionin “Të tjera”, që do të shpallet për cdo procedurë prokurimi, duhet të informojnë se për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, operatori ekonomik duhet të ketë:

- *Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qëndrore të Faturave.*

- *Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softëere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.*

Duke ju falënderuar,

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Drejtor i Përgjithshëm

Delina Ibrahimaj



Agjencia e Prokurimit Publik

Drejtor i Përgjithshëm

Reida Kashta

